

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **329-26-5250-2-3-6**

Sa i përket tenderit për **Servisim dhe Mirembajtje të Air Kondicionereve të AKKVP.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	AS Tech SH.P.K.
NUI	601262611
Adresa	Haxhi Kleqka
Vendi	Lipjan
Kodi postar	-
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	AFRIM SADIKU
Adresa elektronike	shpk.astech@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	03.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Servisim dhe Mirembajtje të Air Kondicionereve të AKKVP.

Ankese kundër Vendimit të AK-se për anulim të procedurës

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Ne sistem janë detajet

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 LPP

Neni 7 LPP

Neni 59 LPP

Neni 62 LPP

45.31 Raporti i vlerësimit përmban diskutimet, vlerësimet e ekzaminimit të tenderëve dhe i njëjti i dorëzohet ZPP për aprovim. Para se Raporti i vlerësimit të aprovohet, ZPP kërkon nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës dëshmitë për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë të specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Pas pranimit të dëshmive të pranueshmërisë, ZPP nënshkruan raportin e Vlerësimit dhe e ngarkon në platformë.

45.32 Pas miratimit të raportit vlerësues nga ZPP, AK do të përgatitë dhe publikoj Formularin B58 Njoftimin mbi vendimin e AK në platformën e prokurimit elektronik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Parashtrojmë këtë Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK), të datës 17.07.2026, për anulimin e procedurës "Servisimi dhe Mirëmbajtja e Air Kondicionerëve të AKKVP".

Vlerësojmë se AK nuk ka asnjë bazë ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit, e aq më pak për eliminimin e ofertës së AS Tech Sh.P.K.

AK ka bërë shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullores për Rregullat e Prokurimit Publik (RRUOPP) në fuqi gjatë nxjerrjes së vendimit për anulimin e procedurës. Nga Raporti i Vlerësimit rezulton qartë se oferta e AS Tech Sh.P.K. është rekomanduar për dhënie të kontratës. Pra, Njoftimi mbi Vendimin e AK-së nuk korrespondon me Raportin e Vlerësimit, i cili është përgatitur paraprakisht dhe përbën bazën e nxjerrjes së vendimit. Me këtë rast është shkelur neni 45.31 i RRUOPP-së, i cili përcakton: "Raporti i vlerësimit përmban diskutimet dhe vlerësimet e ekzaminimit të tenderëve dhe i njëjti i dorëzohet ZPP-së për aprovim. Para se Raporti i Vlerësimit të aprovohet, ZPP kërkon nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës dëshmitë për përmbushjen e kërkesave të pranueshmërisë të specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Pas pranimit të dëshmive të pranueshmërisë, ZPP nënshkruan Raportin e Vlerësimit dhe e ngarkon atë në platformë."

Po ashtu, neni 45.32 i RRUOPP-së përcakton: "Pas miratimit të Raportit të Vlerësimit nga ZPP, AK do të përgatisë dhe publikojë Formularin B58 – Njoftimin mbi Vendimin e AK-së në platformën e prokurimit elektronik."

Raporti i Vlerësimit është dokument zyrtar, i nënshkruar nga tre anëtarët e komisionit vlerësues dhe i konfirmuar e aprovuar edhe nga Personi Përgjegjës i Prokurimit.

Raporti është hartuar më datë 13.07.2026, datë në të cilën kompanisë sonë i janë kërkuar edhe dëshmitë e përshtatshmërisë, të cilat i kemi dorëzuar menjëherë, sipas kërkesës së AK-së.

ZPP ne Vendimin per refuzim te Kerkeses per rishqyrtim bie ne lajthitje kur thot qe Raporti i vleresimit nuk eshte detyrues per AK-se, kur ne realitet vete e ka nenshkru ose aprovu Raportin dhe nuk ka dhene asnje argument kunder antareve te komisionit qe ne raport e kan rekomanduar oferten e As tech shpk .DMTH ZPP ka qene i mendimit bashakarisht me antaret e komisionit qe oferten e As tech ta rekomandoj pasi edhe vertetimat i ka kerkuar por qe pas 4 dite ka dal me nje vendim unanim, qe bie ne kundershtrim m raportin e vleresimit qe vete e ka nenshkruar.

Referuar Vendimit të AK-së, janë paraqitur disa arsyetime për eliminimin e ofertës sonë, të cilat nuk korrespondojnë me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Sipas AK-së, oferta jonë ka tejkaluar vlerën e parashikuar prej 4,500.00 euro. Mirëpo, oferta jonë financiare është në vlerën 4,495.00 euro, pra brenda vlerës së parashikuar. AK ka bërë një analizë hipotetike duke kalkuluar mundësinë që kategoria e dytë e pjesëve rezervë të shfrytëzohet deri në vlerën 1,000.00 euro dhe, mbi këtë bazë, ka konstatuar se

oferta jonë tejkalon vlerën e parashikuar. Ky arsyetim nuk qëndron. Ne kemi plotësuar paramasën saktësisht sipas kërkesave të AK-së, duke respektuar sasitë e përcaktuara për secilën kategori. Për më tepër, çmimet e dhëna në paramasë janë identike me çmimet e paraqitura në Formularin e Dorëzimit të Tenderit (FDT). Ne kemi ofertuar brenda cmimit te percaktuar,

Ne implementim te kontrates ne momentin qe kontrata do te mberrinte vleren e kontrates atehere ajo do te perfundonte, ne nuk mund te penalizohemi per diqka qe AK ka mendu se to ta shfrytezoj, ne gjykohevi vetem ne baze te asaj qka AK ka kerkuar ne paramse e ne te cilen jemi shume ne rregull.

Në asnjë rrethanë nuk kemi mundur të devijojmë nga paramasa, pasi një veprim i tillë do të përbënte shkelje të LPP-së. Shtrohet pyetja: si mund të eliminohet oferta jonë mbi bazën e një kriteri që nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit? LPP dhe RRUOPP përcaktojnë qartë se një operator ekonomik nuk mund të eliminohet për një kriter që nuk është bërë pjesë e dokumentacionit të tenderit. Shkelje tjetër nga ana e AK-së është trajtimi i njëjtë i ofertës së operatorit ekonomik Infnit me ofertën e AS Tech Sh.P.K. për kinse tejkalim të vlerës së parashikuar.

Nga dokumentacioni në dispozicion dhe nga Raporti i Vlerësimit rezulton se oferta e operatorit ekonomik Infnit është dashur të eliminohej, pasi përmban gabime aritmetike mbi 2%, duke mos pasqyruar në Formularin e Dorëzimit të Tenderit çmimet e paraqitura në paramasë, edhe ne kete rast AK ne Vendim te saj nuk e pasqyron gjendjen reale dhe komentet dhe vleresimin e komisionit te vleresimit.

Ne Vendim te AK-se thuhet se edhe oferta e OE Infnit ka tejkaluar vleren e parashikuar, ndersa ne vendimin per refuzim te kerkeses per rishqyrtim, ZPP cek qe OE Infnit eshte eleminuarr per shkak te cmimit ne FDT dhe ndryshimit me paramase.

Ketu kemi nje kunderthenie, ZPP kesaj here e merr si mase te detyrueshme rekomandimin e komisionit te vleresimit, perderi sa ne rastin e vleresimitte ofertes tone e cilesoj qe se ka per detyrim te merr per baze rekomandimin e Komisionit te vleresimit. Ne kete rast ka perdor standarde te dyfishta qe eshte e ndaluar me LPP.

Merkojme aprovimin e kësaj ankese, shfuqizimin e Vendimit për anulimin e procedurës, mthim te lendes ne rivleresim dhe vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren për Rregullat e Prokurimit Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te papercaktuara

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*